



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 29. 09. 2020

VENDIM

Nr. 91, datë 29. 09. 2020

**PËR
MIRATIM TË EMERTIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER
PROFESIONAL "TEKNIK LABORATORI KIMIK"**

Mbështetur në neni 25 pika 7, neni 38 pika 1 shkronja dh, nenin 72 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 10 pika 6, neni 19 pika 1 shkronja ë, të Statutit të Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 14 .01. 2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Udhëzimit nr. 23, datë 28. 09.2020 "Për një shtesë në udhëzimin nr. 1 datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të nryshuar, Senati Akademik në mbledhjen e datës 25. 09.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Kimisë me shkresë nr. 388 prot, datë 28. 09. 2020 për një ndryshim emërtimi në programin e studimit me karakter profesional nga "Teknik Laboratori" në "Teknik laborator kimik".
2. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI**



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEKANI

Vlorë, më 26/09/2020

Nr 388/ Prot.

Lënda: Përcjellje e kërkesës së Departamentit të Kimisë për saktësim emri të programit profesional.

KRYETARIT TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE
PROF. DR. ROLAND ZISI

I nderuar Z. Kryetar!

Po ju përcjellim shkresën e Departamentit të Kimisë për saktësimin e emrit të programit me karakter profesional "Teknik Laboratori".

-Bashkëngjitur kërkesa e Departamentit të Kimisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DEKANI
Prof. Asoc. Hajdar KICAJ

Hajdar Kicaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I KIMISË

Nr. 308 Prot.

Vlorë, më 28 / 09 / 2020

Lënda: Kërkesë për saktësim emri të Programit Profesional "Teknik laborator"

Drejtuar: Dekanit të Fakultetit të Shkencave Teknike
Prof. Asoc. Hajdar KIÇAJ

I nderuar Dekan!

Bazuar në sugjerimin e ekspertit të jashtëm për hapjen e programit të studimit me karakter profesional "Teknik laborator", kërkojmë ndryshimin e emërtimit të programit në "Teknik laborator kimik".

Për këtë ndryshim nevojitet edhe miratimi i senatit akademik.

Përgjegjës i Departamentit të Kimisë
Prof. As. Flora QARRI

Flora Qarri

Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje

